

C.nr. 369/16

**GJYKATA THEMELORE GJAKOVË, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil**, me gjyqtaren Afijete Sada-Gllogjani dhe sekretaren juridike Vjollca Gaxha, në çështjen juridike të paditësit A.M.N., Republika e Shqipërisë, kundër të paditurit A.B.Sh. nga Komuna e Gjakovës, tani me vendqëndrim në komunën e Kaçanikut, për kompensim dëmi, vlera e kontestit 3610.00€, pas përfundimit të shqyrtimit kryesor të mbajtur me datë 16 maj 2019, në prezencën e paditësit dhe në mungesë të paditurit, murr këtë:

## A K T G J Y K I M

**I. PJESËRISHT** aprovohet kërkesëpadija e paditësit A.N. nga Republika e Shqipërisë dhe **DETYROHET** i padituri A.B.Sh. nga komuna e Gjakovës, me vendqëndrim në komunën e Kaçanikut që paditësit në emër të kompensimit të dëmit të shkaktuar me vjedhjen e laptopit me datë 10 qershor 2015 të ia paguaj shumën prej 434.00€, (katërqind e tridhjetë e katër euro) me kamatë ligjore sipas normës 8% duke filluar nga data e marrjes së këtij Aktgjykimi deri në pagesën definitive si dhe të ai kompensoi shpenzimet procedurale në shumë prej 45.00€, krejt këto në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të aktgjykimit, nën kërcënim të përmbarrimit me dhunë.

**II.** Përtej shumës së aprovuar kërkesa në lartësi prej 3167.00€ (tremijenjëqind e gjashtëdhjeteshtatë euro) u **REFUZUA SI E PABAZUAR.**

## A r s y e t i m

Paditësi me padi dhe gjatë shqyrtimit ka parashtruar se: i padituri me datën 10 qershor 2015 në Gjakovë, përkatësisht në Kolegjin Privat "U." me qëllim të përvetësimit të kundërligjshëm për vete ka hyrë brenda dhe në administratën e Kolegjit paditësit ia ka marr (vjedhë) laptopin e tipit "Dell" ngjyrë të zez të vitit 2012 të vendosur në një çantë në vlerë prej 550.00€, ku pastaj ka ik nga vendi i ngjarjes ndërsa laptopin ia ka shit një personi në Pejë. Lidhur me atë vjedhje i padituri ka pranuar fajësinë pranë Gjykatës, është shpallur fajtor dhe është dënuar me gjobë dhe me burgim sipas Aktgjykimit P.nr.558/14 të datës 31 maj 2016.

Me atë veprim i padituri, paditësit i ka shkaktuar dëm të konsiderueshëm, nga se laptopi ka ne vlerë 550.00€, çanta në vlerë prej 60.00€ si dhe dëmin tjetër me humbjen e të dhënave si janë; fotografite private të paditësit dhe familjes së tij mbi 1500 copë, video incizimet private 12 video, punimet seminarike të studimeve, 22 punime të tilla, nga se paditësi në atë kohë ka qenë student kur i padituri ia ka vjedh laptopin dhe ka pas të përgatitura 22 punime prej vitit 2012 e tutje, prej të cilave 6 punime seminarike i kishte për të i prezantuar gjatë vitit akademik 2015-16 si dhe të shumë e shumë të dhëna të tjera të rëndësishme, humbja e të cilave i ka shkaktuar dëm të madh paditësit vlera e të cilave është 3000.00€.

Ka propozua që padia të aprovohet si e bazuar në shumën prej 3610.00€ nga fakti se në laptopin e vjedhur ka pas gjësende të tij dhe familjes të ruajtura në te duke konsideruar se as çmimi i kërkuar nuk i mbulon.

Shpenzimet procedurale i kërkoi për taksë gjyqësore dhe ekspertizë.

Shqyrtimin e kryesor të treguar me datë 16 maj 2019 Gjykata e ka mbajtur në mungesë të paditurit të ftuar në mënyrë të rregullt, bazuar në nenin 432.4 të LPK-së dhe sipas propozimit të paditësit.

Për të vendosur në këtë çështje juridike gjykata bëri nxjerrjen e provave si; shkresave të lëndës të kësaj gjykate P.nr.558/15, ekspertizës financiare të datës 14 shkurt 2019, ku pas vlerësimit veç e veç të këtyre provave dhe në lidhshmërinë e tyre reciproke gjeti se kërkesë padia e paditësit është pjesërisht e bazuar dhe si e tillë u aprovua.

Nga shkresat e lëndës së kësaj Gjykate P.nr.558/15 vërtetohet se i padituri me datën 10 qershor 2015 në Gjakovë, respektivisht në Kolegjin Privat "U." me qëllim të përvetësimit të kundërligjshëm për vete ka hyrë brenda dhe në administratën e Kolegjit të dëmtuarit A.N. ia ka marr laptopin e tipit "Dell" ngjyrë e zezë të vendosur në një çantë në vlerë prej 550.00€ ku më pastaj ik nga vendi i ngjarjes ndërsa laptopin ia shet një personi në Pejë në shumë prej 40.00€. Me ato veprime ka kryer veprën penale vjedhje nga neni 325 paragrafi 1 të KPRK-së dhe është gjykuar me dënim me gjobë në shumë prej 300.00€ dhe dënim me kusht duke ia vërtetuar dënimin me burg në kohëzgjatje prej 6 muajve i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari në afatin e verifikimit prej 1 viti nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nuk kryen vepër tjetër penale.

Gjatë procedurës penale në shqyrtimin fillestar i akuzuari A.1. ka pranuar fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë dhe ka theksuar se është penduar për rastin e ndodhur dhe ka premtuar në të ardhmen nuk do të përsërisë veprimet e tilla. I dëmtuari A.2. për realizimin e kërkesës pasurore juridike është udhëzuar në kontest të rregullt juridiko civil. Aktgjykimi P.nr.558/15 i datës 31 maj 2016 është i plotfuqishëm nga data 05 gusht 2016.

Nga shkresat e lëndës penale është vërtetuar fajësia e të paditurit dhe se i njëjti është përgjegjës për dëmin e shkaktuar paditësit.

Eksperti financiar H.B. ekonomist i diplomuar me ekspertizën datës 14 shkurt 2019, ka bërë vlerësimin e pajisjes laptop të markës "Dell" dhe çantës së laptopit.

Laptopi i markës "Dell" me ngjyrë të zezë, prodhim i vitit 2012 me çantë eksperti ka bërë vizitë në firmat që tregtojnë pajisje si laptop e të tjerë dhe atë në firmat "ASTECH" dhe "Neptun" që tregtojnë në Gjakovë. Në ato firma laptopi i markës "Dell" ka çmim rreth 360.00€ dhe çanta 74.00€. Sipas shënimeve del se vlera e laptopit me çantë është në shumë prej 434.00€.

Nga shkresat e lëndës penale është vërtetuar fajësia e të paditurit.

Bazuar në nenin 169 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve është paraparë që personi përgjigjes ka për detyrë ta rivendosë gjendjen e cila ka qenë në të holla para se të shkaktohet dëmi. Kur rivendosja e gjendjes së mëparshme nuk është e mundur, apo kur gjykata konsideron se nuk është e domosdoshme që këtë ta bënë personi përgjigjës, gjykata do të caktoj që ai të ia paguaj të dëmtuarit shumën përkatëse në të holla në emër të shpërblimit të dëmit.

Neni 173 i të njëjtit Ligj rregullon edhe çështjen e vëllimit të shpërblimit të dëmit material. Lartësia e shpërblimit të dëmit caktohet sipas çmimeve në kohën e nxjerrjes së vendimit gjyqësor, përveç nëse me ligj parashikohet diçka tjetër.

Lartësia e dëmit u vërtetua bazuar në ekspertizën financiare.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale u murr bazuar në nenin 452 të LPK-së ku janë përfshirë shpenzimet për taksë gjyqësore në shumë 25,00€ dhe ekspertizë shumën 20,00€, gjithsejtë shumën 45,00€.

Nga sa u cek më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE GJAKOVË**  
**C.nr. 369/16, Datë 16 maj 2019**

**Gj y q t a r j a,**  
**Afijete Sada Glllogjani**

**UDHËZIM JURIDIK;** Kundër këtij Aktgjykimi është e lejuar Ankesa, në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes së tij Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate.